

20221502010

**LIGJ PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT ME HUA
NGA BANKA NDËRKOMBËTARE E RINDËRTIMIT DHE E ZHVILLIMIT – BANKA
BOTËRORE SIPAS MARRËVESHJES SË HUAS PËR FINANCIM SHITESË TË
PROJEKTIT PËR LIDHJEN E RRUGËVE LOKALE**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut merr hua në vlerë prej 37.000.000 euro nga Banka Ndërkombëtare e Zhvillimit dhe e Rindërtimit - Banka Botërore, të paracaktuar për financim shtesë të Projektit të lidhjes së rrugëve lokale.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas së nenit 1 të këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshjen e huas për financim shtesë të Projektit të lidhjes së rrugëve lokale, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit - Bankës Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, arrëveshjen e huas së paragrafi 1 të këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 3

Afati i pagimit të huas së nenit 1 të këtij ligji është 11 vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej tre vjetësh.

Norma e interesit është EURIBOR gjashtëmujor me marginë variabile.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së huas së nenit 2 paragrafi 1 të këtij ligji, Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit - Bankës Botërore provizion të njëhershëm në vlerë prej 0.25 % të vlerës së huas.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit - Bankës Botërore provizion në vlerë prej 0.25% të pjesës së patërhequr të huas në nivel vjetor.

Huaja sipas nenit 1 të këtij ligji do të paguhet në 16 këste gjysmëvjetore me vlerë kësti prej 6.25% të vlerës së huas. Huaja do të paguhet më datë 15 mars dhe 15 shtator çdo vit.

Neni 4

Shfrytëzues i mjeteve të huas të nenit 1 të këtij ligji është Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve.

Neni 5

Republika e Maqedonisë së Veriut huan sipas nenit 1 të këtij ligji do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 6

Qarkullimi i të mirave dhe i shërbimeve i kryer ndaj Ministrisë së Transportit dhe të Lidhjeve, të paracaktuara për Projektin e lidhjes së rrugëve lokale, të financuar me Marrëveshjen e huas së nenit 2 të këtij ligji lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar me të drejtë të zbritjes së tatimit paraprak.

Importi i të mirave/mallrave nga Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve, të paracaktuara në lidhje me Projektin e lidhjes së rrugëve lokale, të financuar me Marrëveshjen e huas së nenit 2 të këtij ligji, lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar, detyrimet importuese, akciza e emergjentëve dhe tatimi mbi automjetet motorike për automjetet për udhëtim.

Për qarkullimin i cili është kryer ndaj Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, për qëllime të Projektit të lidhjes së rrugëve lokale, të financuar me Marrëveshjen e huas së nenit 2 të këtij ligji, për të cilin i njëjti është debitor tatimor sipas nenit 32 pika 4 dhe nenit 32-a të Ligjit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, lirohet nga detyrimi që ta përllogarisë dhe paguajë tatimin mbi vlerën e shtuar.

Debitori tatimor i cili kryen qarkullim për të cilin është liruar nga tatimi mbi vlerën e shtuar në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, detyrimisht përveç emrit (titullit) të pranuesit të së mirës ose shfrytëzuesit të shërbimit, në faturë e shënon edhe titullin e projektit dhe titullin e Marrëveshjes së huas së neni 2 të këtij ligji.

Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve gjatë importit të të mirave/mallrave të liruara sipas paragrafit 2 të këtij neni, organit kompetent tatimor detyrimisht i dorëzon kopje të Marrëveshjes së huas së nenit 2 të këtij ligji dhe deklaratë se të mirat/mallrat e importuara janë të dedikuara për realizimin e Projektit të lidhjes së rrugëve lokale, të financuar me Marrëveshjen e huas së nenit 2 të këtij ligji.

Neni 7

Të mirat/mallrat që ishin të liruara nga pagesa e tatimit mbi vlerën e shtuar, detyrimet importuese, akciza e emergjentëve dhe tatimi mbi automjetet motorike për automjetet për udhëtim në bazë të nenit 6 paragrafi 2 të këtij ligji, në afat prej tre vjetësh nga dita e importit, nuk guxojnë të tjetërsohen, të jepen për shfrytëzim të tjetrit, të huazohen ose të përdoren ndryshe për qëllime tjera, e jo për ato për të cilat ishin liruar nga pagesa e tatimit mbi vlerën e shtuar, detyrimet importuese, akciza e emergjenteve dhe tatimi mbi automjetet motorike për automjetet për udhëtim, para se të paguhet detyrimet. Të mirat/mallrat nuk guxojnë të lihen peng, të huazohen ose të jepen si sigurim për detyrime tjera.

Nëse zotëruesi i tëë drejtës, para përfundimit të afatit sipas paragrafit 1 të këtij neni, të mirat/mallrat të cilat kanë qenë të liruara nga pagesa e detyrimeve në bazë të nenit 6 paragrafi 2 të këtij ligji, ka për qëllim ta përdorë për qëllime të tjera, e jo për ato për të cilat është liruar nga pagimi i detyrimeve importuese, parashtron kërkesë për pagesën e borxhit doganor te organi doganor.

Lartësinë e borxhit doganor të paragrafit 2 të këtij neni, organi doganor e përllogarit në bazë të elementeve për përcaktimin e detyrimeve që ishin në fuqi në momentin e parashtrimit të kërkesës për pagimin e borxhit doganor.

Në rast të mosrespektimit të dispozitave të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, lartësia e borxhit doganor përllogaritet në bazë të elementeve për përcaktimin e detyrimeve në momentin e pranimit të deklaratës doganore, në bazë të së cilës malli është liruar nga pagesa e detyrimeve importuese.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".